

Tirano nr 03.06.2021



**AKT - THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE
"EnerWind" SH.P.K.**

Neni 1- FORMIMI

Themelohet Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "EnerWind" Sh.p.k me Ortak te vetem z. Blerim Devolli.

Neni 2 - SELIA

Shoqeria Tregtare "EnerWind" Sh.p.k. e ka seline ne: Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Abdyl Frasheri, nr. 31, Pallati Hekla, kati i 3te, Tirane.

Neni 3 - KOHEZGJATJA

Shoqeria Tregtare "EnerWind" Sh.p.k. ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike te pakufizuar.

Neni 4 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike i Shoqerise Tregtare "EnerWind" Sh.p.k. eshte:

- Prodhimi energjise elektrike duke shfrytezuar burimet e energjise te cilat gjenden ne natyre dhe jane te rinovueshme.
- Projektimi dhe Zbatimi, Studimi i Termo Centraleve apo/dhe Impianteve te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjenden ne natyre dhe qe jane te rinovueshme, si dhe i Nenstacioneve e Linjave te Transmetimit TU & TL.
- Ndertimi, Projektimi, Menaxhimi, Mirembajtje dhe Operimi ne fushen e Termocentraleve apo/dhe Impianteve te cilat shfrytezojne energjinee rinovueshme.
- Shitja e energjise elektrike klienteve apo / dhe blerja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shtetor brenda dhe jashte vendit.
- Transmetimi i energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte, funksion i cili perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar.
- Perdorimin e sistemeve te linjave, strukturave mbeshtetese dhe pajisjesh, transformuese e kontrolluese per transmetimin e energjise elektrike.
- Operator i sistemit te transmetimit per te kryer aktivitetin e transmetimit te energjise elektrike dhe te dispegerimit (axhustim ose rregullimi i prodhimit te energjise elektrike sipas kerkesave te konsumit, ne nivel kombetar.
- Shperndarjen, transportin e energjise elektrike ne sistemet shperndarese te tensionit, te mesem dhe te ulet, duke patur parasysh shperndarjen deri tek konsumatori i fundit.
- Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha lejeve dhe licensave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti tregtar ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise.

Shoqeria ka te drejtë te ushtrojë çdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji në perputhje me rregullat e dispozitat ligjore ne fuqi. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse te lëshuara nga organet kompetente te fushes.

Neni 5 - KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i Shoqerise Tregtare "EnerWind" Sh.p.k eshte 140 leke (njqind e dyzet), i cili do te shlyhet gjithi nga Ortaku i vetem i Shoqerise. Kapitali perbehet nga 1 kuote.

Neni 6

Shoqeria Tregtare "EnerWind" Sh.p.k. ka si Administrator te saj znj. Jola Haxhistasa, shtetase shqiptare, lindur me 08.06.1980, ne Berat dhe banuese ne Tirane, Rr. Margarita Tutulani, P. 19, Shk. 1, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. 036764965 dhe nr. Personal I05608063E, per nje afat 5 vjecar.

Administratori mund te jape doreheqjen ose te revokohet nga shumica e ortakeve ne cdo moment.

Kompetencat e administratorit do te ushtrohen ne perputhje me parashikimet e legjislacionit ne fuqi dhe statutit te shoqerise.

Neni 7- SHPERBERJA E SHOQERISE

Shperberja e Shoqerise Tregtare "EnerWind" Sh.p.k. mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredolloj shkak, duke vepruar sipas kriterëve te parashikuara ne Statutin e Shoqerise.

ORTAKU I VETEM THEMELUES TE SHOQERISE TREGTARE "EnerWind" Sh.p.k



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LAURA L. PUSTINA**



V2021053330102187419

**DATE 03/06/2021
NR REP 1497**

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 03/06/2021, para meje Noteres LAURA L. PUSTINA, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.5, ABDYL FRASHERI, NR.31, NR.6, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT:

Jola Haxhistasa, atësia Piro, amësia Veronika, shtetase Shqiptare, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Margarita Tutulani Pall 19; Nd. 1828; H. 0; Ap. 022; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 08/06/1980, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036764965 dhe nr. personal I05608063E, e cila me paraqiti dokumentin origjinal:

Akt themelimi i shoqërisë EnerWind shpk.

Unë Noterja, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjës në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noteres, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

LAURA L. PUSTINA

